

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURES SHTETËRORE 2023

LËNDA: EKONOMI

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30	31	32
Pikët								
Kërkesa	33							
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Mënyra se si një shoqëri prodhon dhe shpërndan të mirat dhe shërbimet quhet: **1 pikë**
- A) lakore e prodhimit
B) sistem ekonomik
C) kosto oportune
D) standard jetese
2. Cila nga alternativat e mëposhtme përbën një problem mikroekonomik? **1 pikë**
- A) Rritja ekonomike
B) Ndryshimi në nivelin e përgjithshëm të çmimeve
C) Përcaktimi i çmimit të produktit nga firma
D) Numri i të papunëve në ekonominë e një vendi
3. Në qoftë se një mall e ka kërkesën joelastike: **1 pikë**
- A) Një rritje 1% në çmim të mallit shkakton një rritje me më pak se 1% në sasinë e kërkuar
B) Një rritje 1% në çmim të mallit shkakton një rritje me më shumë se 1% në sasinë e kërkuar
C) Një rritje 1% në çmim të mallit shkakton një rënje me më shumë se 1% në sasinë e kërkuar
D) Një rritje 1% ne çmimin e mallit shkakton një rënje me më pak se 1% në sasinë e kërkuar
4. Në tregun e televizorëve kemi teprice kërkesë kur: **1 pikë**
- A) Sasia e kërkuar e televizorëve nga konsumatorët në treg e tejkalon sasinë e ofruar
B) Sasia e ofruar e televizorëve nga firma në treg është më e vogël se sasia e kërkuar
C) Sasia e televizorëve te ofruar tejkalon sasinë e televizorëve te kërkuar
D) Sasia e ofruar e televizorëve dhe sasia e kërkuar janë te barabarta
5. Të ardhurat e konsumatorëve u rritën 5%, kërkesa u rrit më pak se 2%, në këtë rast ne themi se malli është: **1 pikë**
- A) e mirë normale
B) e mirë inferiore
C) e mirë zëvendësuese
D) e mirë plotësuese
6. Inflacioni që shkaktohet nga rritja e çmimit të faktorëve të prodhimit quhet: **1 pikë**
- A) inflacion i moderuar
B) inflacion galopant
C) inflacion nga kostoja
D) inflacion nga kërkesa
7. Është faktor i jashtëm që shpjegon ciklet e biznesit: **1 pikë**
- A) ngjarjet e rëndësishme politike
B) investimet e firmave
C) rritja e shpenzimeve të konsumatorëve
D) rritja e shpenzimeve të qeverisë

8. GDP e matur me çmimet korente quhet: 1 pikë

- A) GDP me çmime fikse
- B) GDP reale
- C) GDP nominale
- D) GDP me çmime të periudhës bazë

9. Cila nga alternativat e mëposhtme tregon që firma duhet të vazhdojë të punësoj punëtor: 1 pikë

- A) MRPL > MWC
- B) MRPL < MWC
- C) MRPT = MCT
- D) MRPL = MWC

10. Të ardhurat marginale na tregojnë: 1 pikë

- A) të ardhurat totale që ka siguruar firma në një periudhë kohe
- B) të ardhurat shtese kur firma prodhon një njësi më shumë
- C) të ardhurat që ka siguruar për çdo njësi produkti të shitur
- D) çmimin e tregut me sasinë e produktit të shitur

11. Në fund të muajit buxheti juaj ju tregon se duhet të shkurtoni shpenzimet e përmuajshme. Cilën nga pagesat e mëposhtme do te ishte më e këshillueshme të shkurtonit? 1 pikë

- A) Shpenzimet për qiranë e banesës
- B) Shpenzimet për këstин e kredisë
- C) Shpenzimet për ushqim
- D) Shpenzimet për abonimin satelitor

12. Jeni duke hartuar buxhetin tuaj personal dhe vini re se disa para ju teprojnë. Cili do të ishte veprimi më i mirë dhe i këshillueshëm që duhet të bënit? 1 pikë

- A) Të blini një dhuratë për motrën tuaj
- B) T'i vendosni në fondin tuaj të kursimeve
- C) Të argëtoheni duke shkuar në lokal me shokët
- D) Të shpenzoni për një send luksi

13. Dilemat etike zgjidhen në mënyrën e duhur kur: 1 pikë

- A) mbështeten te besimi juaj
- B) bazohen në vlerat personale
- C) zgjedhjet bëhen nga interesat e çastit
- D) zgjedhjet bëhen nga interesat e miqve

14. Një buxhet quhet suficitar kur: 1 pikë

- A) të ardhurat janë më të vogla se shpenzimet
- B) shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat
- C) të ardhurat janë më të mëdha se shpenzimet
- D) të ardhurat janë të barabarta me shpenzimet

- 15.** Nga alternativat e mëposhtme cila mund të jetë një e mirë publike? 1 pikë
- A) Prodhimi i automobilave
 - B) Prodhimi nënprodukteve të qumështit
 - C) Nxjerra dhe përpunimi i naftës
 - D) Mbrojtja kombëtare
- 16.** Supozojmë se një numër i madh studentësh diplomohen në degën ekonomi. Në një situatë të tillë çfarë do të ndodhë në tregun e punës së ekonomistëve? 1 pikë
- A) Oferta e punës do të rritej, si pasojë niveli i pagës do të ulej.
 - B) Oferta e punës do të ulej, si pasojë niveli i pagës do të ulej.
 - C) Oferta e punës do të rritej, si pasojë niveli i pagës do të rritej.
 - D) Oferta e punës do të ulej, si pasojë paga nuk do të ndryshonte.
- 17.** Qeveria po koordinon veprimtaritë e saj për mbrojtjen e mjedisit. Cilin nga funksionet po ushtron ajo? 1 pikë
- A) Mbrojtjen e konsumatorit
 - B) Trajtimin e eksternaliteteve
 - C) Garantimin e pronës private
 - D) Garantimin e konkurrencës
- 18.** Cili nga pohimet e mëposhtëm përbën detyrim etik sipas teorisë së palëve të interesuara? 1 pikë
- A) Detyrimi që parësorë janë pronarët e biznesit.
 - B) Detyrimi që biznesi duhet t'i parashikojë dëmet.
 - C) Detyrimi që një biznes duhet t'i bindet vetëm ligjit.
 - D) Detyrimi që nuk duhet të shpenzojë para, nëse nuk sjell para shtesë.
- 19.** Ema bën pyetje, parashikon dhe mbledh informacion për arsimin e lartë në Shqipëri dhe në vende të tjera. Cila është aftësia për sukses që po përdor Ema në këtë rast? 1 pikë
- A) Vrojton me kujdes
 - B) Përcjell ide me shkrim
 - C) Mëson përmes kërkimit
 - D) Dëgjon në mënyrë aktive
- 20.** Cili është hapi i fundit për një sipërmarrje të suksesshme? 1 pikë
- A) Përcaktimi i tregut
 - B) Hartimi i planit të biznesit
 - C) Zgjedhja e produktit të duhur
 - D) Marrja e informacionit në treg
- 21.** Në një treg të veshjeve sportive, çmimi ka ndryshuar nga: 6 në 10 lekë dhe sasia ka ndryshuar nga 40 në 80 copë. Tregoni: 4 pikë
- a) Për çfarë elasticiteti bëhet fjalë (kërkese apo ofertë)
 - b) Sa është elasticiteti në këtë rast ?
 - c) Si është kërkesa ose oferta në këtë rast?
 - d) Bëni paraqitjen grafike të këtij elasticiteti?

22.Tregoni një tipar të përbashkëta dhe dy tipare dalluese ndërmjet struktureve së tregut oligopol dhe konkurrencës monopolistike. 3 pikë

Të përbashkëtat

1) _____

Dallimet

1) _____

2) _____

23.Tregoni tre faktorë që do të rrisnin ofertën për një të mirë ose shërbim në treg. 3 pikë

1) _____

2) _____

3) _____

24.Supozojmë se kemi një firmë që operon në konkurrencë të plotë në tregun e punës dhe në tregjet e produkteve, nëse çmimi i produktit është 10 dhe paga është 40 njësi paraje gjeni: 3 pikë

L	0	1	2	3	4	5	6
TPP	0	3	10	24	36	40	42

a) Sa është sasia optimale e punës që do të blejë firma?

b) Për këtë sasi optimale tregoni:

- Sa janë të ardhurat marginale nga produkti punë?

- Sa është kosto marginale e punës?

25.Argumentoni efektet që do të shkaktonte një ulje e ofertës monetare në ekonomi lidhur me: 3 pikë

Normën e interesit _____

Shpenzimet e konsumatorëve _____

Nivelin e përgjithshëm të çmimeve _____

26.Jepet tabela e mëposhtme na tregon mundësitë që ka një vend për të prodhuar dy produkte.Tregoni: **3 pikë**

Kombinimet e mundshme	Tekstile	Ushqime
A	30	-
B	20	15
C	15	18
D	5	24
E	-	35

a) Kur kalojmë nga kombinimi A në kombinimin B sa është zgjedhja?

b) Kur kalojmë nga kombinimi A në kombinimin B sa është kostoja oportune?

c) Çfarë prirje vihet re për prodhimin e tekstileve?

27.Banka Qendrore harton, miraton dhe zbaton politikën monetare duke kontrolluar ofertën e parasë, në këtë mënyrë ajo ndikon në zhvillimin ekonomik të një vendi. Cilët janë treguesit ekonomik në të cilët ajo ndikon?

3 pikë

1) _____

2) _____

3) _____

28.Tregoni tri nga përparësítë e firmave individuale.

3 pikë

1) _____

2) _____

3) _____

29. Në një ekonomi të supozuar prodhohen vetëm dy mallra, ushqime dhe veshje. Të dhënrat për sasitë dhe çmimet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme. Duke supozuar si vit bazë vitin 2010, gjeni:

3 pikë

Shporta e mallrave	Sasitë (2010)	Çmimet (2010)	Sasitë (2017)	Çmimet (2017)
Ushqime	1000 njësi	100 lekë	1000 njësi	150 lekë
Veshje	1200 njësi	150 lekë	1500 njësi	300 lekë

a) Sa është GDP nominale?

b) Sa është GDP reale?

c) Si llogaritet efekti i rritjes së cmimeve në GDP?

30. Jepet tabela e mëposhtme e cila tregon sasinë e produktit që prodhohet dhe njësinë e punës të një firme, duke ditur që madhësia e kapitalit është e fiksuar.

3 pikë

Puna	Produkti
0	0
1	30
2	70
3	120
4	200
5	260
6	300

a) Për cilën periudhë prodhimi bëhet fjalë?

b) Tregoni sa është produkti mesatar fizik kur firma ka punësuar 4 punëtorë?

c) Sa është produkti marginal kur firma ka punësuar 5 punëtorë?

31. Një firmë prodhon sasitë e outputit me kostot e paraqitura në tabelën mëposhtme. Nëse firma vepron në periudhë afatshkurtër. Tregoni:

3 pikë

Sasia	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Kostoja e përgjithshme	10	14	17	19	22	26	31	37	44	52	62

a) Sa është kostoja mesatare kur firma prodhon 4 njësi?

b) Sa është kostoja marginale kur firma prodhon 4 njësi?

c) Sa është kostoja fikse e firmës?

32. Vlera e CPI-së së SHBA-së në vitin 1927 ka qenë 17.4 ndërsa në vitin 1928 shkoi në 17.1. Bazuar në këto të dhëna zyrtare:

2 pikë

a) Llogaritni normën e inflacionit ndërmjet këtyre viteve.

b) Përcaktoni nëse është inflacion, deflacion apo disinflacion.

33. Tabela e mëposhtme tregon sasinë e kërkuar dhe sasinë e ofruar për çdo nivel çmimi në treg. Duke u mbështetur në këtë tabelë:

4 pikë

P (Çmimi)	1	2	3	4	5	6	7
Q _D (Sasia e kërkuar)	19	18	17	16	15	14	13
Q _S (Sasia e ofruar)	7	9	11	13	15	17	19

a) Përcaktoni sasinë ekuilibër.

b) Përcaktoni çmimin ekuilibër.

c) Nëse qeveria ndërhyr duke vendosur çmimin 4 njësi paraje, tregoni si do të quhet ky çmim?

d) Për këtë çmim të vendosur nga qeveria në çfarë gjendje ndodhet tregu?
